



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Bushati takon Diasporën Shqiptare në New York: qeveria shqiptare e angazhuar për jetësimin e një marrëdhënie të re me shqiptarët jashtë atdheut

2017-09-23 15:19:00



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, i cili gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të marrë pjesë në Sesionin e 72-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, zhvilloi gjatë ditës së sotme një bashkëbisedim me përfaqësues të Diasporës Shqiptare në Nju Jork.

Në këtë takim mori pjesë edhe Zv. Kryeministri i Parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Ministri Bushati shprehu vlerësimin e tij maksimal për bashkatdhetarët tanë në Shtetet e Bashkuara, jo vetëm për kontributin e tyre ndaj atdheut por edhe nivelin e lartë të integritimit në shoqërinë amerikane, ndërsa rikonfirmoi angazhimin e tij të plotë në thellimin e bashkëpunimit me diasporën, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.

Ai vuri në dukje nismat e Qeverisë shqiptare për jetësimin e një marrëdhënie të re me shqiptarët jashtë atdheut, angazhimin e tyre në zhvillimet e vendit, si dhe të Ministrisë që ai drejton në veçanti.

Këtu mund të theksohet zhvillimi i suksesshëm i Samitit të Parë të Diasporës në Tiranë më 18-20 nëntor 2016, ku një numër shumë i madh i shqiptarëve nga SHBA-të morën pjesë aktivisht në punimet e Samitit, si dhe lançimi i suksesshëm i shërbimeve konsullore online, të cilat ofrojnë shërbime më të shpejta, të lira dhe transparente për të gjithë shqiptarët.

Ai gjithashtu vuri në dukjen angazhimin për regjistrimin e shqiptarëve jashtë atdheut dhe mundësimin e tyre për të votuar nga kudo ku jetojnë që nga zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2021.

Në këtë kuadër, ai vuri në dukje dhe ngritjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën në qeverinë e re, e cila do të mbartë peshën e madhe të përgjegjësisë për ri-vitalizimin e marrëdhënieve me diasporën dhe angazhimin e saj aktiv në zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit.